



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMLORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:149840

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474401

CPP.nr.279/21

GJYKATA THEMLORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K..., me seli në Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit për energji elektrike, vlera 1401.43 euro, duke rivendosur sipas prapësimit të debitorit A.M nga Vushtrri, të ushtruar kundër urdhrin të Përmbaruesit Privat A... nga Vushtrria, mbi lejimin e përmbarimit P.nr.858/18 e datës 09.11.2018, jashtë seance, me datën 19.03.2024, e mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET prapësimi i debitorit A.M nga Vushtrri i pa bazuar, mbetet ne fuqi urdhri i Përmbaruesit Privat A... nga Vushtrria, mbi lejimin e përmbarimit P.nr.858/18 e datës 09.11.2018 dhe OBLIGOHET debitori që në emër të borxhit për shfrytëzimin e energjisë elektrike, për periudhën kohore nga data 26.10.2015-05.10.2018, kreditorit të ia paguaj shumën prej 1401.43 euro, me kamatë ligjor prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbarim, e deri në pagesën definitive të borxhit, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, e nën kërcënimin e përmbarimit dhunshëm.

II. Në rast ankese kundër këtij aktvendimi urdhërohet pala ankuese që konform nenit 78 par.1 të LPP-së paraprakisht të paguaj garancinë në të holla në shumë prej 1401.43 euro si parakusht për parashtrimin e ankesës, në të kundërtën, gjykata konform nenit 78 par.4 të LPP-së do të konsideroj se ankesa nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat për Territorin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, A..., ka nxjerr urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.858/18 e datës 09.11.2018, sipas propozimit të kreditorit K..., me seli në Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit për energji elektrike, vlera 1401,43 euro, me të cilën ka lejuar bllokimin e të gjitha llogarive në të gjitha bankat komerciale të debitorit si dhe regjistrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, në afatin ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, duke e kundërshtuar në tërësi borgjin ndaj kreditorit dhe atë duke theksuar se borxhi është parashkruar,

andaj për këto arsye i ka propozuar gjykatës që të aprovon prapësimin e debitorit dhe ta anuloj urdhërin përmbarues.

Kreditori K... në afatin ligjore ka parashtruar përgjigje në prapsim duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pa bazuar sepse debitori ka bërë disa pagesa të kohë pas kohshme dhe ka ndërprerë afatin e parashkrimit. Debitori nuk ka dorëzuar provat me shkrim, andaj nga këto arsye i ka propozuar gjykatës që të refuzon prapësimin e debitorit.

Gjykata, pas shqyrtimit me kujdes të shtuar të prapësimit të debitorit dhe përgjegjëjes në prapësim të kreditorit në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës erdh në përfundim se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar për këto arsye si vijon:

Gjykata fillimisht vlerëson se ekstraktet nga librat afarist të kreditorit paraqesin dokument të besueshëm në bazë të nenit 29 par.1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Gjykata shqyrtoi me kujdes prapësimin e debitorit dhe përgjigjen e kreditorit në prapësim dhe në bazë të librave afarist të kreditorit erdhi në përfundim se debitori gjatë periudhes kohore 26.10.2015 e gjerë me datën 05.10.2018, i kanë ardh faturat për pagesë të energjisë elektrike në lartësi prej 1401.43 euro.

Gjykata në pajtim me aktvendimet e Gjykates së Apelit në Prishtinë dhe provave në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit se borxhi është parashkruar është i pa bazuar, pasi që në rastin konkret debitori ka bërë disa pagesa të energjisë elektrike, me të cilat pagesa ka manifestuar pranimin e borxhit dhe ex lege ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit konform nenit 368 par 1 të LMD-së ku përcaktohet se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”, ndërsa në par.2 të këtij neni përcaktohet se: “Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit vecse edhe në mënyrë të tërthort sikurse janë pagesa e këstit, kamatës, dhënia e sigurimit”.

Nga arsyet e theksuara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë të nenit 73 pika 3 të Ligjit për procedurën Përmbarimore.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
CPP.nr.279/21, datë: 19.03.2024

G J Y Q T A R I
Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.